



Një Udhëzues për Familjet Shumëgjuhëshe dhe Emigrante në Shkollat Publike të Nju Jorkut







Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes.....	3
Çfarë është ky udhëzues?	4
Cilat janë të drejtat e fëmijës tim si nxënës emigrant?.....	6
Si dhe ku ta regjistroj fëmijën tim në shkollë?	7
Me kë do të ndërveproj unë në shkollë?.....	8
Si mund të përfaqësoj interesat e fëmijës tim në shkollë?.....	9
Programi për Nxënësit e Gjuhës Angleze	10
Përfitimet e Dygjuhësisë.....	11
Çfarë ndodh nëse shkolla ime nuk ofron programe dygjuhëshe?.....	12
Fëmija im ka nevoja të veçanta dhe/ose një aftësi të kufizuar. Çfarë duhet të bëj?	12
Po sikur të kem më shumë pyetje?	12
Cilat janë disa nga opsionet pas shkollore të fëmijës tim?	13
Kontakt	15
Shtojca e URLs-ve.....	16



Çfarë është ky udhëzues?

Ky udhëzues do t'ju ndihmojë të kuptoni sistemin shkollor të Nju Jorkut. Duke filluar me procesin e regjistrimit, ju mund ta përdorni këtë udhëzues për të kuptuar të drejtat tuaja si prind i një shkolle publike në Nju Jork; programet gjuhësore dhe shërbimet e disponueshme në shkolla për të mbështetur si të mësuarit e fëmijës tuaj ashtu edhe angazhimin tuaj me arsimin e fëmijës; disa mundësi pas shkollore për fëmijën tuaj; ku të shprehni shqetësimet tuaja; dhe burimet e disponueshme në qytet për të lehtësuar tranzicionin tuaj në Qytetin e Nju Jorkut.

Të nderuara familje,

Mirë se vini në komunitetin e Shkollave Publike të Qytetit të Nju Jorkut! Qyteti ynë është një ndërthurje e bukur kulturash, gjuhësh dhe traditash nga e gjithë bota. Në shkollat tona, ne e festojmë këtë diversitet dhe përpiqemi që të krijojmë një mjedis ku çdo nxënës ndihet i vlerësuar dhe i pranuar me racën e tyre, gjuhën dhe statusin e emigracionit. Ne besojmë se çdo kulturë shton një fije unike në qilimin e komunitetit tonë dhe ne inkurajojmë të gjithë nxënësit të përqafojnë dhe të ndajnë trashëgiminë e tyre.

Si prindër dhe kujdestarë, roli juaj në arsimimin e fëmijëve tuaj është jetik. Ne ju inkurajojmë që të vazhdoni të kultivoni kulturën tuaj në shtëpi dhe ta ndani atë me fëmijët tuaj. Këto elemente kulturore, qofshin gjuhë, ushqim, muzikë, arte apo tradita, mund ta pasurojnë shumë përvojën mësimore të fëmijëve tuaj dhe t'i ndihmojnë ata të vlerësojnë rrënjët e tyre.

Në shkollat tona, fëmijët tuaj do të mësojnë së bashku me bashkëmoshatarë nga prejardhje të ndryshme, duke fituar një një kuptim të çmuar mbi diversitetin e botës. Ne presim me padurim të bashkëpunojmë me ju në këtë udhëtim edukativ, duke ofruar një përvojë të pasur, të larmishme dhe gjithëpërfshirëse mësimi që i përgatit ata për një të ardhme të ndritur.

Cilat janë të drejtat e fëmijës tim si nxënës emigrant?

- Në Qytetin e Nju Jorkut, të gjithë fëmijët, pavarësisht statusit të emigracionit, kanë të drejtën për një arsimim në shkollat publike. Punonjësit e DOE nuk do të pyesin për statusin tuaj të emigracionit dhe as nuk do të kërkojnë dëshmi të shtetësisë, dhe nëse ndodh që ata të mësojnë për statusin e emigracionit të dikujt, ata janë të detyruar ta mbajnë atë konfidencial.
- Shkollave dhe distrikteve u ndalohet të ofrojnë informacione për nxënësit dhe familjet e tyre për këdo, duke përfshirë "Immigration Customs Enforcement" (Agjencia për Emigracionin dhe Doganat), përveç rasteve kur kërkohet me ligj ose me pëlqimin e prindërve.
- Për t'ju ndihmuar të mësoni informacione të rëndësishme, shkollat ofrojnë shërbime falas përkthimi në shumë gjuhë. Ju mund të kërkontë shërbime ndihme gjuhësore në shkollën e nxënësit në çdo kohë! Kërkontë te koordinatori i prindërve, te drejtori/ drejtoresha, ose plotësoni [Translation and Interpretation Services Request Form](#).
- Nëse dëshironi të dini më shumë rreth të drejtave tuaja si prindër të Nxënësve të Gjuhës Angleze/ Shumëgjuhësh, ju lutemi shkoni te DOE website dhe kërkontë për "[Bill of Rights](#)."



Si dhe ku ta regjistroj fëmijën tim në shkollë?

A po pyesni veten tani: nga duhet t'ja nis? Si mund ta regjistroj fëmijën tim në shkollat publike të Nju Jorkut?

Hapi i parë për të regjistruar fëmijën tuaj është të vizitoni një "Family Welcome Center" (Qendra e Mirëseardhjes për Familjet) pranë jush.

Mbani mend, nuk keni përse të tregoni statusin tuaj të emigracionit ose të tregoni ID tuaj. Stafii në "Family Welcome Center" (Qendra e Mirëseardhjes për Familjet) do t'ju tregojë se cili dokumentacion nevojitet për regjistrimin. Në shumicën e rasteve, do t'ju kërkohet:

- **dëshmi e moshës së fëmijës tuaj,**
- **regjistrat e vaksinimit** (nëse janë të disponueshëm),
- raporti më i fundit i notave (nëse është i disponueshëm), dhe
- dy dokumente cilatdo si **dëshmi e adresës.**



Nëse po jetoni në një banesë të përkohshme, ju lutemi shkoni tek [Family Welcome Center](#) sipas zgjedhjes tuaj. Stafii atje do të jetë në gjendje t'ju ndihmojë.



Me kë do të ndërveproj unë në shkollë?

Si një familje e re emigrantësh, sistemi shkollor mund të jetë i vështirë për t'u kuptuar. Ju lutemi jini të sigurt se të gjithë në shkollë janë aty për t'ju ndihmuar. Ka disa lloje personash me të cilët do të ndërveproni rregullisht. Ata janë drejtori ose zëvendësdrejtori, koordinatori i prindërve dhe oficeri i sigurisë së shkollës.

Secili prej tyre ka role të ndryshme në shkollë.

Drejtori/Zëvendësdrejtori është dikush që mbikëqyr veprimtarinë e shkollës, duke përfshirë menaxhimin e stafit, standardet akademike dhe sjelljen e nxënësve. Drejtori është përgjegjës për shumicën e gjërave në ndërtesën e shkollës.



Një **mësues** është dikush që zhvillon mësimdhënien në klasë, duke mësuar të gjitha lëndët në shkollën fillore dhe lëndë specifike në shkollën e mesme të ulët dhe të mesme të lartë.



Një **oficer sigurie i shkollës** bën pjesë në NYPD (Departamenti i Policisë së Qytetit të Nju Jorkut) dhe siguron sigurinë e shkollës, menaxhon situatat emergjente, raporton incidentet serioze të administrata e shkollës dhe të School Safety Division (Divizioni Siguria e Shkollës), edukon për sigurinë dhe nxit një mjedis të përshtatshëm për të mësuar.



Një **koordinator i prindërve** ndihmon prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes të kuptojnë dhe të marrin pjesë në aktivitetet e shkollës, zgjidh çështjet prindër-shkollë dhe siguron që zërat e prindërve të dëgjohen për suksesin e fëmijëve të tyre.



Një **këshillues shkolle** ndihmon nxënësit të identifikojë dhe të planifikojë klasat përkatëse, krijojnë një plan individual për kolegë dhe plan karriere, mbështet përfundimin e aplikimeve për kolegë dhe punë, dhe ndihmon nxënësit të qëndrojnë në rrugën e duhur drejt diplomimit.

Si mund të përfaqësoj interesat e fëmijës tim në shkollë?

Prindërit si ju janë avokati më i mirë i fëmijës! Gjithashtu, si prind i një nxënësi emigrant, ju keni një mundësi unike për të qenë një zë i fuqishëm në tryezë, duke përfaqësuar nevojat e Nxënësve të Gjuhës Angleze dhe grupeve të emigrantëve në tërësi. Ka disa mënyra se si mund të përfshihenit në komunitetin e shkollës. Ju nuk keni përse t’i bashkoheni një ekipi, për të marrë pjesë në arsimimin e fëmijës tuaj, por nëse zgjidhni të jeni një anëtar aktiv i një ekipi, më poshtë janë **tre grupe shkollore** të drejtuara nga prindër. Të gjitha mbledhjet i nënshtrohen ligjit për mbledhjet e hapura, që do të thotë se kushdo mund të marrë pjesë në mbledhje.

Niveli Shkollës	Niveli Distrikt	Niveli Qëndror
PTA (Parent-Teacher Association) është një grup prindërisht vullnetarë të fëmijëve në një shkollë lokale që mbliiden çdo muaj për të diskutuar shqetësimet dhe nivelin e mbështetjes për komunitetin shkollor. Kushdo mund të marrë pjesë në mbledhje, por vetëm bordi zgjidhet për të udhëhequr mbledhjet.	Këshilli i Presidentëve është një grup prindërisht i mbështetur nga një mbikëqyrës arsimor i caktuar. Anëtarët me të drejtë vote janë presidentët e "Parent Association" (Shoqata e Prindërve) ose "Parent-Teacher Association" (Shoqata e Prindërve dhe Mësuesve) brenda një distrikti të caktuar.	Këshillat mbarëqytetës përbëhen nga prindër, nxënës dhe përfaqësues të institucioneve publike zyrtarë. Mbledhjet mujore drejtohen nga prindërit për të diskutuar shqetësimet, për të ofruar mundësi mësimore dhe për të diskutuar çështjet zyrtare. Nëse jeni të interesuar të përfaqësoni prindër të tjerë të Nxënësve të Gjuhës Angleze si ju, ju lutemi konsideroni të bashkohenitni CCELL.
SLT (Ekipi i Drejtimit të Shkollës) përbëhet nga një numër i barabartë prindërisht dhe stafi shkollor, të cilët mbliiden rregullisht për të diskutuar të dhënat e shkollës, kurrikulën, mundësitë dhe programet pas mësimi. Prindërit dhe stafi duhet të zgjidhen me votim në grup.	Këshilli Drejtues i Distriktit është një grup palësh të ndryshme, duke përfshirë prindër, që ofrojnë mendime dhe bëjnë rekomandime mbi politikat dhe nismat e distriktit.	
Konferenca Prind-Mësues është një takim midis prindërve dhe mësuesve për të diskutuar ecurinë akademike dhe socio-emocionale të nxënësve.	Këshillat e Arsimit të Komunitetit janë organe këshilluese të politikave arsimore që janë përgjegjëse, ndër të tjera, për rishikimin dhe vlerësimin e programeve arsimore të distriktit të tyre, miratimin e kufijve të zonimit dhe mbajtjen e seancave dëgjimore publike për çështje të caktuara. Shihni faqen Rolet dhe Përgjegjësitë për një përshkrim më të plotë të asaj që bëjnë anëtarët.	

Programi për Nxënësit e Gjuhës Angleze

Shkollat publike të Nju Jorkut u ofrojnë familjeve të Nxënësve të Gjuhës Angleze tre programe që ndihmojnë fëmijët e tyre të mësojnë anglisht. Këto programe forcojnë zhvillimin e gjuhës amtare të nxënësve dhe njohuritë në lëndë, ndërsa ata ndërtojnë aftësitë e tyre sociale dhe akademike në anglisht.

- **English as a New Language (ENL) (Anglishtja si Gjuhë e Re):** Të gjithë ELL-ët marrin: English as a New Language (ENL) (Anglishtja si Gjuhë e Re). Fëmija juaj do të mësohet të lexojë, të shkruajë dhe të flasë në anglisht me mbështetje në gjuhën amtare të fëmijës tuaj.
- **Arsimi Dygjuhësh me Gjuhë të Dyfishtë (Dual Language Bilingual Education – DLBE):** Qëllimi i këtij programi është që fëmija juaj të lexojë, të shkruajë dhe të flasë në të dyja gjuhët. Pasi fëmija juaj të mos jetë më një Nxënës i Gjuhës Angleze (ELL), fëmija juaj do të qendrojë në program për të mësuar dhe përmirësuar të dyja gjuhët.
- **Arsimi Dygjuhësh Kalimtar (Transitional Bilingual Education – TBE)** Në këto programe, ndërsa fëmija juaj përmirësohet në anglisht, ai do të kalojë më shumë kohë duke mësuar në anglisht dhe më pak kohë duke mësuar në gjuhën amtare. Kur fëmija juaj nuk është më një Nxënës i Gjuhës Angleze (ELL), ai/ajo largohet nga programi.


	DYGJUHËSH ME GJUHË TË DYFISHTË	DYGJUHËSH KALIMTAR	ANGLISHTJA SI GJUHË E RE
Qëllimet e programit	Përdorimi i të dyja gjuhëve për të promovuar dygjuhësinë / dyshkrim-leximin	Përdorimi i gjuhës amtare për të mbështetur aftësinë në anglisht	Përdorimi i gjuhës amtare si një mbështetje për të ndihmuar mësimdhënien në anglisht
Mësimdhënie në gjuhën amtare	✓	✓	✓
Shokë klase me të njëjtën gjuhë amtare	✓	✓	
Mësimdhënie e barabartë në të dyja gjuhët	✓		

Përfitimet e Dygjuhësisë

Kërkimet tregojnë se të dish më shumë se një gjuhë është shumë e dobishme për fëmijët. Të qenit në gjendje të flasësh gjuhë të ndryshme mund t'u ndihmojë njerëzve në çdo moshë. Për fëmijët, kjo mund t'i ndihmojë ata të kenë rezultate më të mira në shkollë. Kur të rriten, kjo mund t'i ndihmojë ata të gjejnë punë më të mira. Gjithashtu, kur të bëhen më të moshuar, kjo mund t'i ndihmojë të mbajnë mendjen e mprehtë dhe madje mund t'i mbrojë nga një sëmundje e trurit e quajtur Alzheimer.



Duke zgjedhur një nga programet dygjuhëshe (Dual Language Bilingual Education – Arsimi Dygjuhësh me Gjuhë të Dyfishtë), fëmija juaj përgatitet më mirë për të marrë një **"Seal of Biliteracy" (Vulë të Dyshkrim-leximit)**. The New York State Seal of Biliteracy (NYSSB) – Vula e Dyshkrim-leximit e Shtetit të Nju Jorkut është një çmim që u jepet maturantëve të shkollave të mesme të cilët kanë treguar aftësi në anglisht dhe të paktën në një gjuhë tjetër. NYSSB inkurajon studimin e gjuhëve, vlerëson diversitetin dhe u ofron universiteteve dhe punëdhënësve informacion shtesë mbi aftësitë gjuhësore të një nxënësi. Nxënësit që plotësojnë kushtet marrin një vulë zyrtare në diplomën e tyre, një medalion dhe një certifikatë nga "New York State Education Department" (Departamenti i Arsimit i Shtetit të Nju Jorkut). NYSSB u sjell përfitime nxënësve duke njohur rëndësinë e dygjuhësisë, duke nxjerrë në pah arritjet e tyre dhe duke ofruar një deklaratë arritjeje për mundësitë e ardhshme.



Çfarë ndodh nëse shkolla ime nuk ofron programe dygjuhëshe?



Nëse shkolla juaj aktualisht nuk ofron programe dygjuhëshe, eksploroni cilat Programe Dygjuhëshe janë të disponueshme në shkollat pranë jush. Ju mund të kërkonti një transferim nëse programi që preferoni nuk ofrohet në shkollën tuaj aktuale, dhe shkolla mund të ndihmojë të udhëheqë dhe mbështesë procesin e transferimit. Ka gjithashtu lloje të ndryshme shkollash që u shërbejnë nevojave të nxënësve shumëgjuhësh dhe emigrantëve të rinj, siç janë shkollat brenda rrjetit ndërkombëtar.

Megjithatë, ju lutemi kini parasysh se pavarësisht se çfarë llojesh shkollash janë, ju gjithmonë mund të kërkonti të vendoseni në një program dygjuhësh.

Fëmija im ka nevoja të veçanta dhe/ose një aftësi të kufizuar. Çfarë duhet të bëj?



Nëse fëmija juaj ka një Individualized Education Plan (IEP – Plani Individual Arsimit), vendosjet në një program Bilingual Special Education (BSE – Arsimit Dygjuhësh për Nxënës me Nevoja të Veçanta) në distriktet 1–32 janë prioritet për nxënësin. Ju mund të kontaktoni BSEprograms@schools.nyc.gov me kërkesat për vendosje në programin BSE.

Po sikur të kem më shumë pyetje?



Nëse keni shqetësime ose pyetje lidhur me procesin e regjistrimit në një program dygjuhësh ose pjesëmarrjes në një nga grupet e prindërve, ju lutemi kontaktoni Koordinatorët e Prindërve, Zëvendës drejtorin, dhe/ose Drejtorin në shkollën tuaj. Ju gjithashtu mund të kontaktoni distriktin tuaj Koordinatori i Mbështetjes për Familjet,


Mbikëqyrësi Arsimit dhe zyra "Family and Community Empowerment" (FACE – Fuqizimi i Familjes dhe Komunitetit).

Cilat janë disa nga opsionet pas shkollore të fëmijës tim?

Opsionet pas shkollore janë mundësitë që nxënësit identifikojnë pas diplomimit nga shkolla e mesme, siç janë hyrja në kolegji, tregun e punës, një program profesional dhe ushtri. Kjo përfshin hyrjen në kolegje ose universitete dy- dhe katër-vjeçare, shkolla profesionale dhe hyrjen në tregun e punës. Të gjithë nxënësit, pavarësisht statusit të emigracionit, mund të ndjekin opsione pas shkollore.

Në Shtetin e Nju Jorkut, studentët pa dokumenta mund të kenë qasje në tarifat e shkollimit si banorë të shtetit dhe asistencë financiare shtetërore për universitete dy- dhe katër- vjeçare. Më poshtë janë burime kyçe për të mbështetur hyrjen në mundësi pas shkollore për studentët pa dokumenta dhe familjet me status të përzier, pavarësisht statusit të emigracionit.

Kornizë për Gatishmërinë Pas Shkollore



Burime Pas Shkollore

Burimet	Kategori	Përshkrimi
NYS Higher Education Services	Tarifat e shkollimit si banor i shtetit dhe Asistencë Financiare për Kolegj	Të gjithë studentët, pavarësisht statusit të emigracionit, mund të ndjekin një universitet 2 ose 4 vjeçar. "New York State Dream Act" (Akti i Ëndrrës i Shtetit të Nju Jorkut) ofron asistencë financiare shtetërore për studentët emigrantë me lloje të ndryshme të statusit të emigracionit që kanë ndjekur një shkollë të mesme të shtetit të NY për të paktën 2 vjet dhe plotësojnë kërkesa të tjera.
Save for College (Kurse për Kolegjin)	Një program bursash dhe kursimi për fëmijët e vegjël të Nju Jorkut. Falas pavarësisht ë ardhurave ose statusit të emigracionit.	"The Save for College Program" (Programi i Kursimit për Kolegjin) është një program universal bursash dhe kursimi i krijuar për t'i bërë trajnimet e kolegjit dhe të karrierës më të arritshme dhe të realizueshme për të gjithë nxënësit e shkollave publike të Nju Jorkut, duke filluar nga kopshti, pavarësisht të ardhurave ose statusit të emigracionit të familjes së tyre.
Emigrant i Informuar	Opsione për nxënës të shkollës së mesme pa dokumenta	Pavarësisht statusit të emigracionit, nxënësit e shkollës së mesme pa dokumenta në shkollat publike të NYC kanë opsione pasi të diplomohen nga shkollat e mesme. Ju mund të zgjidhni të aplikoni për kolegje ose universitete, të shkoni në shkolla profesionale dhe teknike, ose të hyni direkt në tregun e punës.
Road to College Checklist (Lista për Rrugën drejt Kolegjit)	Road to College Checklist (Lista për Rrugën drejt Kolegjit)	Një listë kontrolli e krijuar për nxënësit pa dokumenta në Nju Jork për të parashikuar dhe plotësuar hapat e rekomanduara në rrugëtimin e tyre drejt kolegjit dhe më gjerë. Nxënësit mund të kenë qasje në burime dhe lidhje për të marrë përgjigje për pyetjet.
Identifikoni Emigrante Kolegjet Mikpritëse	Gjetja e Kolegjit	Një dokument njëfaqësh përshkruan disa mënyra për të zbuluar se cilat kolegje janë mikpritëse ndaj emigrantëve.
Zyra e CUNY Pa dokumenta dhe Emigrantë Student Programs	"The City University of New York" (CUNY) (Universiteti i Qytetit të Nju Jorkut (CUNY)) mbështet studentët pa dokumenta dhe emigrantë	CUNY aktualisht ka katër qendra të suksesit të studentëve emigrantë. Këto qendra kanë anëtarë të stafit të përkushtuar dhe të informuar që kuptojnë nuancat e përvojës së studentëve emigrantë dhe atyre pa dokumente. Qendrat ofrojnë mbështetje financiare, ligjore, për shëndetin mendor dhe sociale në një përpjekje për të përfaqësuar dhe fuqizuar në mënyrë holistike studentët emigrantë. Ne po punojmë për të hapur më shumë qendra në të gjithë CUNY-n në një përpjekje për të ofruar qasje dhe burime të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht statusit të emigracionit.

Burime të Qytetit të Nju Jorkut

Qyteti i Nju Jorkut ofron një shumëllojshmëri burimesh që mund të jenë të dobishme për familjet emigrante dhe studentët. Këto burime ju ofrojnë mbështetje gjithëpërfshirëse dhe mundësi për të lulëzuar në rrugëtimet e integritimit arsimor dhe shoqëror. Më poshtë janë disa shembuj të burimeve.

Përshkrimi i Burimeve

"New York City Mayor's Office of Immigrant Affairs" (MOIA) (Zyra e Kryebashkiakut të Qytetit të Nju Jorkut për Çështjet e Emigrantëve (MOIA)) është një agjenci e qytetit për punën me emigrantët. Është një burim i shkëlqyer për të nisur.

Nëse keni nevojë ndonjëherë për një vend për të qëndruar dhe/ose ushqim për ju dhe familjen tuaj, mund të gjeni [shelters](#) dhe [food banks](#) përrreth qytetit.

Ka gjithashtu shumë [Community Based Organizations](#) (CBO) që mund t'ju ndihmojnë me gjëra të ndryshme. Për shembull, nëse keni nevojë për diçka të përshtatur posaçërisht për komunitetet afrikane, organizata "African Community Together" (AFC) (Komuniteti Afrikan Së Bashku (AFC)) mund t'ju ndihmojë me shërbime ligjore për emigrantët, asistencë për bizneset e vogla, zhvillim profesional dhe referime për shërbime sociale të përgjithshme.

Plane shëndetësore me kosto të ulët për familjet emigrante, duke përfshirë Medicaid (emigrantët pa dokumente mund të aplikojnë vetëm për çështje shëndetësore emergjente) dhe Child Health Plus, janë në dispozicion përmes [Office of Citywide Health Insurance Access \(OCHIA\)](#).

Kontakt

Nëse keni shqetësime ose pyetje lidhur me ndonjë nga proceset e regjistrimit në një program dygjuhësh, ose pjesëmarrjes në një nga grupet prindërore, ju lutemi kontaktoni Koordinatorët e Prindërve, Zëvendës drejtorin dhe/ose Drejtorin në shkollën tuaj. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Koordinatorin e Mbështetjes për Familjet dhe Mbikëqyrësin Arsimit të distriktit tuaj. Ose dërgoni email Zyrës së Mësimdhënësve Shumëgjuhësh në multilinguallearners@schools.nyc.gov.

Shtojca e URLs-ve

Faqe 6	Projektligji i të Drejtave  bit.ly/RightsELL	Faqe 6	Family Welcome Center (Qendra e Mirëseardhjes për Familjet)  http://tinyurl.com/3avjw5cy
Faqe 9	CCELL  ccell.org	Faqe 14	CUNY Office of Undocumented and Immigrant Student Program (Zyra e Programit për Studentët pa Dokumenta dhe Emigrantë e CUNY-t)  bit.ly/cunyundoc
Faqe 14	Save for College (Kurse për Kolegjin)  bit.ly/saveforcollege	Faqe 14	Identifikoni Kolegjet Mikpritëse ndaj Emigrantëve  http://tinyurl.com/3djh7f22

Shtojca e URLs-ve

Faqe 14	NYS Higher Education Service (Shërbimi i Arsimit të Lartë i Shtetit të Nju Jorkut)  http://tinyurl.com/4fbhwasr	Faqe 14	Road to College Checklist (Lista për Rugën drejt Kolegjit)  bit.ly/3NSGfHe
Faqe 14	Emigrant i Informuar  tinyurl.com/mrxca3yp	Faqe 15	Organizata me bazë në Komunitet  bit.ly/OMLCBOs
Faqe 15	Office of Citywide Health Insurance (Zyra e Sigurimeve Shëndetësore e të Gjithë Qytetit)  on.nyc.gov/46B9it0	Faqe 15	Lista e Strehve të Nju Jorkut  bit.ly/3JHim5G
Faqe 15	Banka e Ushqimit e Qytetit të NZC  bit.ly/3JHim5G		

